



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1028/1 Prot.

Vlorë më, 17.04.2026

VENDIM

Nr. 19, datë 17.04.2026

PËR

**ÇELJEN E PROCEDURAVE DHE AFATEVE TË APLIKIMIT PËR NJË ANËTAR
NË BORDIN E ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",
VLORË, PËRFAQËSUES I UNIVERSITETIT**

Në mbështetje të nenit 50, pika 1 shkronja d, të nenit 48 dhe të nenit 38, pika 1, shkronja gj, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 19, pika 1, gërma II, nenit 23, pika 3 dhe nenit 24 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 17.04.2026,

VENDOSI:

1. Të shpallë procedurën dhe afatet për përzgjedhjen e **1 (një) anëtar** të Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësues i Universitetit.
2. Kjo procedurë të respektojë fazat dhe afatet e mëposhtme:
 - a) Afati i dorëzimit të dokumenteve për aplikim si kandidat për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësues të universitetit do të jetë nga data **17.04.2026** deri më datë **24.04.2026**.
 - b) Afati i dorëzimit të dokumenteve nga njësitë bazë për të bërë propozimet për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësues të universitetit do të jetë nga data **17.04.2026** deri më datë **24.04.2026**.
 - c) Sekretari i SA tërheq, me procesverbal nga Sektori i Protokoll-Arkivës, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit dhe ia përcjell për shqyrtim Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, i cili ngrihet me vendim të Senatit Akademik.
 - d) Emri i anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i institucionit, përcillet në MAS.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

3. Individët dorëzojnë kërkesën për kandidaturën e tyre me shkrim pranë Sektorit të Protokoll-Arkivës, e cila duhet të përmbajë këto të dhëna dhe dokumente shoqëruese:

- a) Emri, mbiemri dhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni dhe adresë e-mail);
- b) Statusi si personel akademik me kohë të plotë pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (i vërtetuar me dokument përkatës);
- c) Titulli akademik ("Profesor", "Profesor i Asociuar") ose grada shkencore "Doktor", të shoqëruara me dokumentacionin përkatës që vërteton fitimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi;
- d) Njësia kryesore ku ushtron aktivitetin akademik (fakulteti/departamenti);
- e) Deklaratë e nënshkruar që nuk ushtron funksione drejtuese në njësitë kryesore dhe bazë të Universitetit;

4. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

- a) Të jenë personel akademik me kohë të plotë pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;
- b) Të zotërojnë titullin akademik "Profesor", "Profesor i Asociuar", ose gradën shkencore "Doktor", të fituar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- c) Të mos jenë në pozicione drejtuese të njësive kryesore të UV-së;
- d) Të mos jenë drejtues të njësive bazë të institucionit;
- e) Të mos ushtrorin funksionin e Rektorit ose Administratorit pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;
- f) Të përmbushin kriteret e parashikuara në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Drejtuesit e njësive kryesore, Drejtuesit e njësive bazë, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. Aurela Sallaj

